

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “HOTEL NDRRIN” SH.P.K.

Sot, më datën 06.02.2023, **Z. Klaudio SULOLLARI** i lindur në Mazrek, Shqipëri më datë 21 korrik 1990 mbajtës i kartës së identitetit me numër J00721076C, banues në Shqipëri, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “HOTEL NDRRIN” Sh. P. K. si më poshtë vijon

Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “HOTEL NDRRIN”.

Ortak i kësaj shoqërie është **Z. Klaudio SULOLLARI**

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Klaudio SULOLLARI** për një periudhë deri në 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “HOTEL NDRRIN” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “HOTEL NDRRIN” SH.P.K. është : **Durrës, RRASHBULL, SHKALLNUR, Shkëmbi Kavajës Zona Kadastrale 3385, Nr.Pasurie 578/242.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Hoteleri, turizëm.
- Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese.
- Shërbime hotelerie dhe turistike të të gjitha llojeve përfshirë organizim ekskursionesh, shërbime dhe rezervime hotelesh brenda dhe jashtë vendit dhe transport turistësh.
- Bar – Restorant.
- Punime ndërtimi, rikonstruksioni, etj.



- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt. 14.04-08).

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotaash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zoteron një kuota të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

Z. Klaudio SULOLLARI zotëruar i një kuota me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajshme ose të paluajshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I SHOQERISE

Klaudio SULOLLARI

Klaudio Sulollari
